MANIPULIMI RUS I INFORMACIONIT NË MAQEDONINË E VERIUT:

Shfrytëzimi i cenueshmërive përmes mosmarrëveshjeve dypalëshe

RAST STUDIMI

Institute of Communication Studies

respublica

Manipulimi rus i informacionit në Maqedoninë e Veriut: Shfrytëzimi i cenueshmërive përmes mosmarrëveshjeve dypalëshe

RAST STUDIMI

Shkup, 2025

DOI: 10.64370/GNTB9534

Botues:

Instituti për Studime të Komunikimit

Rr. Jurij Gagarin 17/1-1, Shkup

www.iks.edu.mk

Për botuesin:

Dr. Zhaneta Trajkoska

Editor:

Bojan Georgievski

Edicioni:

ResPublica

Titulli origjinal:

„Руско мешање и манипулација со информации во Северна Македонија:

Искористување на ранливости преку билатерални спорови" - студија на случај

Përkthim nga maqedonisht në shqip

Shenasi Jahiu

Redaktimi dhe dizajni grafik:

Ivana Temelkoska

Vendi dhe data:

Shkup, viti 2025

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека «Св. Климент Охридски», Скопје

316.776.23:327(470+571:497.7)(047.31)
316.776.23:327.5(497.2:497.7)(047.31)

MANIPULIMI rus i informacionit në Maqedoninë e Veriut [Електронски извор] : shfrytëzimi i cenueshmërive përmes mosmarrëveshjeve dypalëshe : rast studimi / [editor Bojan Georgievski = përkthim nga maqedonisht në shqip Shenasi Jahiu]. - Shkup : Instituti për studime të komunikimit, 2025. - (Edicioni ResPublica)

Начин на пристапување (URL):
https://respublica.edu.mk/wp-content/uploads/2025/11/russian-fimi-in-n-macedonia_alb.pdf.
- Превод на делото: Руско мешање и манипулација со информации во Северна Македонија : искористување на ранливости преку билатерални спорови : студија на случај. - Текст во PDF формат, содржи 18 стр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 25.12.2025. - Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 18

ISBN 978-608-4805-72-4

а) Русија -- Надворешна политика -- Дезинформации -- Бугарско-македонски спор -- Македонија -- Истражувања

COBISS.MK-ID 67810821

Përmbajtja

Hyrje.....5

Pse është e rëndësishme Maqedonia e Veriut?.....5

Bullgaria si një variabël kontekstuale.....6

Pyetje kërkimore.....7

Burimet/Metodologjia.....7

Konteksti historik: pika e kthesës në vitin 2008.....8

Mosmarrëveshjet rreth identitetit.....9

Anëtarësimi në NATO dhe referendumi i vitit 201810

Vetoja bullgare dhe zhvendosja e fokusit drejt BE-së.....10

Kanalet kryesore të NHMI-së ruse.....12

1. Mediat dhe fushatat e dezinformimit.....12

2. Ndërmjetësit politikë dhe ndikimi i partive politike.....12

3. Institucionet religjioze dhe kulturore.....13

4. Fuqia korporative dhe ekonomike.....13

Mosmarrëveshjet dypalëshe – një cenueshmëri që ofron hapësirë për NHMI-në ruse.....15

Bibliografia.....17

Hyrje

Ndërhyrja e huaj dhe manipulimi i informacionit (NHMI) është bërë një nga mjetet/veglat përcaktuese të politikës së jashtme ruse, veçanërisht në rajonet ku Moska kërkon të ngadalësojë ose parandalojë integrimin euroatlantik. Ballkani Perëndimor është një arenë kritike në këtë luftë. I pozicionuar në vijën ndarëse midis NATO-s dhe Bashkimit Evropian nga njëra anë, dhe lidhjeve historike me Rusinë dhe solidaritetit sllavo-ortodoks nga ana tjetër, rajoni përfaqëson një terren pjellor për operacione dhe ndikim informacioni.

Qëllimi i këtij rast studimi është të ofrojë një analizë gjithëpërfshirëse dhe të bazuar në prova të ndërhyrjes së huaj ruse dhe manipulimit të informacionit (NHMI) në Maqedoninë e Veriut, me një fokus të veçantë në rolin e Bullgarisë. Studimi paraqet një kronologji të momenteve kryesore në NHMI-së ruse dhe identifikon kanalet dhe metodat kryesore të NHMI-së ruse. Përveç kësaj, shpjegon se si mosmarrëveshjet dypalëshe midis Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veriut hapin hapësirë për depërtimin e NHMI-së ruse.

Studimi synon të arrijë dhe identifikojë zyrtarët qeveritarë dhe analistët në Maqedoninë e Veriut dhe Bullgarinë përgjegjës për politikat kundër dezinformimit, sigurinë kombëtare dhe bashkëpunimin rajonal, politikëbërësit evropianë dhe transatlantikë, gazetarët, studiuesit dhe organizatat e shoqërisë civile të dedikuara për promovimin e njohurive mediatike, transparencës dhe rezistencës demokratike, si dhe te publiku i gjerë.

Pse është e rëndësishme Maqedonia e Veriut?

Maqedonia e Veriut është një vend i vogël me më pak se dy milionë banorë, por rëndësia e saj gjeopolitike është disproporcionale me madhësinë e saj. Që nga pavarësia në vitin 1991, vendi është përballur me tensione të brendshme etnike, mosmarrëveshje për emrin dhe historinë me fqinjët e saj, si dhe institucione të brishta demokratike. Ajo u bë zyrtarisht anëtare e NATO-s në mars të vitit 2020 dhe ka qenë kandidate për anëtarësim në BE që nga viti 2005.

Për Rusinë, Maqedonia e Veriut përfaqëson:

- **Fushëbetejë simbolike:** Nëse Rusia mund ta ngadalësojë ose pengojë anëtarësimin e vendit në BE, kjo dëshmon se Perëndimi nuk mund të garantojë zgjerimin as në fqinjësinë e vet. (**The Guardian**, 2017; **EUISS**, 2022; **SAIS Review**, 2023).
- **Disfatë strategjike:** Anëtarësimi i Ballkanit në NATO kufizon drejtpërdrejt ndikimin rus. Prandaj, pengimi i zgjerimit të BE-së është një mënyrë indirekte për të dobësuar konsolidimin e Aleancës. (**RFE/RL**, 2018; **Lansing Institute**, 2022; **EP Think Tank**, 2023).

- **Levë identiteti:** Mosmarrëveshjet me Greqinë (lidhur me çështjen e emrit, e zgjidhur nga Marrëveshja e Prespës në vitin 2018) dhe Bullgarinë (lidhur me gjuhën dhe historinë) kanë ofruar pika hyrëse perfekte për fushatat e dezinformimit që theksojnë tradhtinë, poshtërimin ose përçarjen. (Intellinews, 2023; The Geopost, 2023; IEMed, 2023; Bellingcat, 2020).

Raportet e fundit konfirmojnë se Maqedonia e Veriut vazhdon të jetë një objektiv i aktiviteteve të koordinuara nga NHMI-ja ruse. Raporti analitik i Fondacionit Metamorfozis mbi Manipulimin dhe Ndërhyrjen e Informacionit të Huaj (NHMI) në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2024) thekson amplifikimin e vazhdueshëm të narrativave pro-ruse në vend përmes kanaleve të ndryshme.

Në rastin e Maqedonisë, qëllimi kryesor i ndërhyrjes dhe manipulimit të informacionit rus është të nxisë mosbesimin ndaj institucioneve perëndimore dhe të delegjitimojë autoritetet maqedonase që konsiderohen pro-perëndimore. (EEAS, 2022; Bellingcat, 2020; Analytics.IntSecurity, 2023; Lansing Institute, 2022; EP Think Tank, 2023; EDMO, 2025; Intellinews, 2023).

Metodat e përdorura nga Rusia për të arritur këtë qëllim janë të ndryshme:

- Dezinformimi dhe propaganda në mediat tradicionale dhe online.
- Mbështetja e partive nacionaliste ose euroskeptike.
- Rrjetet fetare dhe kulturore, veçanërisht nëpërmjet kishës ortodokse.
- Fuqia korporative dhe ekonomike, veçanërisht në fushën e energjisë.
- Operacionet e inteligjencës, duke përfshirë taktikat kibernetike dhe destabilizimin e fshehtë.

Bullgaria si një variabël kontekstuale

Nuk mund të analizohet NHMI-ja e Rusisë në Maqedoninë e Veriut pa njohur rolin e Bullgarisë, një anëtare e BE-së dhe NATO-s. Që nga viti 2020, Sofja ka bllokuar në mënyrë efektive pranimin e Shkupit zyrtar në BE duke kërkuar në njohjen kushtetuese të një pakice bullgare dhe duke sfiduar elementë të identitetit dhe gjuhës maqedonase.

Nga perspektiva e Rusisë, kjo përçarje dypalëshe është një dhuratë strategjike:

- Vonon zgjerimin e BE-së pa pasur nevojë që Moska të lëvizë një gisht.
- Konfirmon narrativat se BE-ja është e dobët dhe peng i mosmarrëveshjeve të brendshme.
- Ofron një pikë hyrjeje për operacionet e ndikimit rus, të cilat mund të përforcojnë ankesat në të dy anët e kufirit.

Prandaj, ky studim shqyrton rolin e Bullgarisë si një shtet, politika e brendshme dhe mosmarrëveshjet e identitetit të të cilit krijojnë një cenueshmëri kontekstuale që Moska e shfrytëzon në mënyrë oportuniste.

Pyetje kërkimore

Ky rast studimi pyet: Si e zbaton Rusia NHMI-në në Maqedoninë e Veriut, cilat janë kanalet dhe metodologjitë e saj kryesore dhe cili është roli i Bullgarisë në krijimin e një hapësire më të madhe për këto fushata?

Burimet/Metodologjia

Analiza në masë të madhe mbështetet në raportime me burime të hapura dhe studime analitike, duke përfshirë dokumente të rrjedhura të inteligjencës (The Guardian), gazetari investigative (Bellingcat, RFE/RL), analiza të grupeve të ekspertëve (Lansing Institute, ISS, SAIS Review, Global Influence Ops, IEMed), botime institucionale të BE-së (EEAS, EP Think Tank) dhe ekspertizë rajonale (Demokratization Policy Council, Geopost), si dhe raporte nga media të shumta. Së bashku, këto burime na lejojnë të rindërtojmë si metodat ashtu edhe efektet e SMMI-së ruse në Maqedoninë e Veriut gjatë dy dekadave të fundit.

Konteksti historik: pika e kthesës në vitin 2008

2008	Në samitin e NATO-s në Bukuresht, përpjekja e Maqedonisë për t›u bërë pjesë e Aleancës u bllokua nga Greqia për shkak të mosmarrëveshjes për emrin. Ndonëse zhgënjyese për Maqedoninë e Veriut, ky ishte një rezultat i mirëpritur për Moskën.
2017	Dosjet e inteligjencës të publikuara nga „The Guardian“ sugjerojnë se pas bllokadës së anëtarësimit në NATO në vitin 2008, shërbimet ruse të inteligjencës e kanë shënjestruar sistematikisht Maqedoninë për një dekadë me fushata ndikimi që synonin nxitjen e përçarjeve dhe vonimin e integrimit në NATO.
2018	Gjatë negociatave për Marrëveshjen e Prespës, partitë politike pro-ruse, mediat dhe llogaritë e mediave sociale të lidhura me Rusinë e amplifikuan mesazhin se marrëveshja ishte një diktat perëndimor, i hartuar për të fshirë identitetin dhe kulturën maqedonase. Megjithatë, Maqedonia e Veriut u bë zyrtarisht pjesë e NATO-s në mars të vitit 2020. Për Rusinë, kjo ishte një disfatë strategjike.
2020	Me anëtarësimin e vulosur në NATO, ndërhyrja ruse është rikalibruar drejt zgjerimit të BE-së. Mundësia kryesore lindi kur Bullgaria vuri veton në negociatat e anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut për çështje të gjuhës, identitetit dhe njohjes së pakicave.
2022	Kryeministri bullgar Kiril Petkov dhe presidenti maqedonas Stevo Pendarovski ranë dakord se shërbimet sekrete ruse kanë punuar për të ndezur tensionet dypalëshe midis dy vendeve dhe për të bllokuar progresin e BE-së.
2024	Hulumtimi nga VIGINUM i quajtur „PORTAL KOMBAT – a structured and coordinated pro-Russian propaganda network“ - i cili hartëzoi të paktën 193 portale online që përhapin propagandën ruse, ndër të tjera, zbulon ekzistencën e një rrjeti më të gjerë Pravda që është i pranishëm në disa vende në Evropë, Azi dhe Afrikë. Portali Pravda Severna Makedonija është pjesë e tij.
2025	Raporti i tretë i EEAS mbi kërcënimet nga NHMI-të thotë se «fushatat ruse kërkojnë të shfrytëzojnë dobësitë specifike lokale në sferat politike, sociale dhe teknologjike me përmbajtje të përshtatur me kujdes, veçanërisht aty ku Rusia kërkon të përparojë interesat e saj të politikës së jashtme dhe të sigurisë». Mosmarrëveshjet dypalëshe midis Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veriut krijojnë një situatë vulnerabël që Rusia e shfrytëzon për NHMI-të e saj.

Në samitin e NATO-s në Bukuresht të vitit 2008, përpjekja e Maqedonisë për t'u anëtarësuar në Aleancë u bllokua nga Greqia për shkak të mosmarrëveshjes për emrin. Ndonëse zhgënjyese për Maqedoninë e Veriut, ky ishte një rezultat i mirëpritur për Moskën.

Dosjet e inteligjencës të publikuara në vitin 2017 dhe të publikuara nga „The Guardian" sugjerojnë se që nga kjo pikë e tutje, shërbimet ruse të inteligjencës e kanë shënjestruar Maqedoninë në mënyrë sistematike me fushata ndikimi që synojnë nxitjen e mosmarrëveshjeve dhe vonimin e integrimit në NATO. Dosjet e përshkruajnë qasjen e Moskës si ndërtim të "ndikimit të fshehtë politik, ekonomik dhe kulturor" për të parandaluar zgjerimin e NATO-s në Ballkan.

Gazeta "The Guardian" raportoi në atë kohë se "gjatë nëntë viteve të fundit, Maqedonia ka qenë shënjestër e një propagande të fortë subversive dhe aktiviteti inteligjence të udhëhequr nga ambasada ruse, sipas një informimi të përgatitur për Vladimir Atanasovskin, drejtor i Drejtorisë së Sigurisë dhe Kundërzbulimit (UBK) të Maqedonisë." Dokumenti thoshte: "Duke përdorur mjetet dhe metodat e të ashtuquajturës fuqi të butë, si pjesë e strategjisë së Federatës Ruse në Ballkan, qëllimi është të izolohet vendi [Maqedonia] nga ndikimi perëndimor."

Dosjet e publikuara hedhin dritë gjithashtu mbi mënyrën se si Kremlini kryen spiunazh. Tre agjentë nga shërbimi i inteligjencës së jashtme të Rusisë, SVR, thuhet se janë të vendosur në Shkup dhe janë nën mbikëqyrjen e stacionit simotër të SVR në kryeqytetin serb, Beograd. Ambasada ruse në Maqedoni është gjithashtu shtëpia e katër spiunëve nga agjencia e inteligjencës ushtarake të Rusisë, GRU, aktivitetet e të cilëve koordinohen nga baza e GRU-së në Sofje të Bullgarisë.

Mosmarrëveshjet rreth identitetit

Mosmarrëveshja për emrin me Greqinë (e zgjidhur në vitin 2018 me Marrëveshjen e Prespës) dhe mosmarrëveshjet pasuese me Bullgarinë (pas vitit 2020) e kanë bërë Maqedoninë e Veriut të cenueshme. Fushatat ruse të dezinformimit kanë theksuar vazhdimisht temat e tradhtisë kombëtare, humbjes së identitetit dhe imponimit të jashtëm. Këto narrativa kanë depërtuar thellë në shoqërinë maqedonase, e cila tashmë ishte e kujdesshme ndaj ndërhyrjes së huaj në sovranitetin e saj.

Gjatë negociatave për Marrëveshjen e Prespës, aktorët e lidhur me Rusinë, respektivisht partitë politike pro-ruse, mediumet dhe profilet në rrjetet sociale, përforcuan mesazhet se marrëveshja ishte një diktat perëndimor, i hartuar për të fshirë identitetin dhe kulturën maqedonase.

Në mesin e partive politike pro-ruse, veçohet Maqedonia e Bashkuar dhe presidenti i saj Janko Baçev, të cilët haptazi avokojnë për "aleancën e Maqedonisë me Rusinë". Baçev ka pritur Aleksandar Dugin dhe Leonid Savin në Maqedoni në disa raste, të dy bashkëpunëtorë të ngushtë të Presidentit rus Vladimir Putin, të cilët konsiderohen ideologë të politikës së jashtme ruse. Në prag të referendumit të vitit 2018 mbi Marrëveshjen e Prespës, ata morën pjesë në një panel-diskutim me ftesë të Maqedonisë së Bashkuar me temën: „Republika e Maqedonisë në një aleancë strategjike me Rusinë dhe anëtarësimi në Unionin Ekonomik Euroaziatik". më vonë atë vit, Savini i trajnoi anëtarët e Maqedonisë së Bashkuar se si të merrnin pushtetin në Maqedoni.

Anëtarësimi në NATO dhe referendumi i vitit 2018

Referendumi i vitit 2018 për Marrëveshjen e Prespës ishte një pikë kyçe e nxehtë. Marrëveshja ishte një parakusht për t'u bashkuar me NATO-n dhe BE-në, por pjesëmarrja u shtyp qëllimisht nga fushatat e dezinformimit.

Sekretari i atëhershëm i Mbrojtjes i SHBA-së, James Mattis, paralajmëroi në mënyrë direkte se Rusia po financonte dhe po përhapte narrativa të rreme për të ulur pjesëmarrjen dhe për të inkurajuar bojkotin.

Gazeta „New York Times" publikoi gjetjet e një hetimi nga Projekti i Raportimit të Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (OCCRP), i cili zbuloi se të paktën 300,000 euro iu dhanë kundërshtarëve të riemërtimit të vendit nga Ivan Savvidi, një miliarder rus që jeton në Greqi dhe ish-anëtar i parlamentit rus.

Grupet lokale dhe ndërkombëtare të monitorimit të medias kanë dokumentuar aktivitet të koordinuar në Facebook dhe Twitter, shpesh të lidhura me ferma trollësh ose media pro-ruse, duke përhapur pretendime se anëtarësimi në NATO do të sjellë luftë ose dominim nga korporatat perëndimore.

Kremlini përdori gjithashtu rrjetet fetare: elementë të Kishës Ortodokse Ruse dyshohet se ushtruan presion mbi Kishën Ortodokse Maqedonase që të mos pranonte një kompromis me Greqinë, duke forcuar opozitën nacionaliste.

Edhe pse pjesëmarrja në referendum ishte nën pragun e kërkuar, qeveria e atëhershme, e udhëhequr nga kryeministri Zoran Zaev, vazhdoi me ndryshimet kushtetuese dhe Maqedonia e Veriut u bashkua zyrtarisht me NATO-n në mars të vitit 2020. Për Rusinë, kjo ishte një disfatë strategjike, por forcoi vendosmërinë e Moskës për të parandaluar hapin tjetër: anëtarësimin në BE.

Vetoja bullgare dhe zhvendosja e fokusit drejt BE-së

Me anëtarësimin e vulosur në NATO, ndërhyrja ruse është rikalibruar drejt zgjerimit të BE-së. Mundësia kryesore lindi në nëntor 2020, kur Bullgaria vuri veton në negociatat e pranimit të Maqedonisë së Veriut për çështje të gjuhës, identitetit dhe njohjes së pakicave.

Për Moskën, ishte një skenar pothuajse i përsosur:

- Është një anëtar i BE-së dhe NATO-s (Bullgaria), jo Rusia, që ka penguar progresin.
- Dezinformatat e lidhura me Rusinë përforcuan shpejt idenë se "BE nuk do ta pranojë kurrë Maqedoninë", duke e portretizuar procesin e anëtarësimit si poshtërues dhe të pafund.
- Aktorët pro-rusë në Maqedoninë e Veriut e kanë përdorur krizën për të argumentuar se vendi duhet të përpiqet për neutralitet ose lidhje më të ngushta me partnerët jo-perëndimorë.

Vetoja bullgare ka ndezur një luftë propagande midis Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veriut - më saktësisht midis qarqeve nacionaliste dhe folësve në të dy vendet. Sipas botimit The Pro-Russian Propaganda Machine in Bulgaria, and the Russian Style Representations of North Macedonia (Journal for Politics, Gender and Culture, 2023) në këtë luftë, paketa propagandistike ruse po përdoret si armë

për të nxitur nacionalizmin dhe rënien e BE-së dhe NATO-s, të cilat janë qëllimet kryesore të luftës hibride të Rusisë.

Një botim tjetër nga kolegji polak The College of Eastern Europe, i titulluar „The Russian Trojan horse in the EU: Bulgaria's flawed democracy and Russian kleptocratic interests" thekson se Bullgaria ndoshta mund të përshkruhet si hallka më e dobët brenda BE-së, ku një mjedis i korruptuar dhe rrjete klienteliste lejojnë depërtimin e thellë nga aktorët pro-rusë. Me fjalë të tjera, situata e palakmueshme politike në Bullgari ofron terren pjellor për përhapjen e ndikimit rus.

Kanalet kryesore të NHMI-së ruse

NHMI-ja ruse nuk kufizohet vetëm në një platformë ose mjet të vetëm. Përkundrazi, ajo vepron si një sistem shumëkanalësh, i projektuar për të shfrytëzuar dobësitë e një shoqërie të vogël, të polarizuar me institucione demokratike të brishta. Mund të identifikohen pesë kanale kryesore: media dhe dezinformimi, ndërmjetësit politikë, institucionet fetare dhe kulturore, pushteti korporativ/ekonomik dhe operacionet e inteligjencës/të fshehta.

1. Mediat dhe fushatat e dezinformimit

Ndoshta ndikimi më i dukshëm rus është përmes sferës mediatike. Moska ka investuar prej kohësh në krijimin, financimin ose forcimin e kanaleve që pasqyrojnë narrativat e saj gjeopolitike, të tilla si *Russia Today (RT), Sputnik, TASS, RIA Novosti.*

Edhe pse RT është ndaluar në Maqedoni, përmbajtja nga ky medium dhe media të tjera ruse që përhapin propagandën ruse hyn në valët e transmetimit maqedonas direkt përmes portaleve online si Pravda Severna Makedonija, Kolozheg dhe të tjerë, përmes rrjeteve sociale ose përmes portaleve në gjuhën serbe. Hulumtimi nga VIGINUM France's service for vigilance and protection against foreign digital interference) - i quajtur „PORTAL KOMBAT – a structured and coordinated pro-Russian propaganda network" - i cili hartëzoi të paktën 193 portale online që përhapin propagandën ruse, ndër të tjera, zbulon ekzistencën e një rrjeti më të gjerë *Pravda* që është i pranishëm në disa vende në Evropë, Azi dhe Afrikë, dhe portali *Pravda Severna Makedonija* është pjesë e tij.

Ata nxitën narrativa tradhtie dhe poshtërimi gjatë kohës së Marrëveshjes së Prespës (me Greqinë) dhe mosmarrëveshjeve me Bullgarinë. Dezinformimi e portretizoi kompromisin si një "shitje" të identitetit maqedonas nën presionin e Perëndimit

Një shembull i kësaj është ndërhyrja në zgjedhje, siç dokumentohet nga Bellingcat përpara zgjedhjeve parlamentare të vitit 2020, ku faqet e lidhura me Rusinë dhe rrjetet e trollëve përhapën mesazhe anti-perëndimore dhe u përpoqën të ulnin pjesëmarrjen në zgjedhje.

Këto fushata nuk kërkojnë mbështetjen e shumicës, por synojnë të polarizojnë shoqërinë, të dobësojnë besimin në institucione dhe të minojnë konsensusin në vend për integrimin perëndimor.

2. Ndërmjetësit politikë dhe ndikimi i partive politike

Një tjetër kanal për NHMI-në është mbështetja për partitë politike. Analistët në Institutin Lancing dhe grupe të tjera think-tank kanë theksuar se Rusia mban marrëdhënie me partitë nacionaliste dhe euroskeptike në Ballkanin Perëndimor. Grupet më të vogla radikale, përfshirë ato që mbështesin "neutralitetin" ose lidhje më të ngushta me Rusinë, ushqehen gjithashtu nga fushatat e dezinformimit.

Kanalet e financimit janë të paqarta, por rrjedhjet e inteligjencës sugjerojnë se ambasadat dhe qendrat kulturore ruse kanë mbështetur fshehurazi aktorë të caktuar politikë.

Të gjithë këta tregues sugjerojnë se qëllimi nuk është të zgjidhet një "qeveri pro-ruse", por të sigurohet që asnjë qeveri në Shkup të mos ketë një mandat të qartë për ta përqafuar plotësisht Perëndimin.

3. Institucionet religjioze dhe kulturore

Feja është një kanal delikat, por i fuqishëm i NHMI-së ruse. Kisha Ortodokse Ruse historikisht ka mbajtur lidhje të ngushta me komunitetet ortodokse ballkanike, duke përfshirë fraksionet brenda Kishës Ortodokse Maqedonase. Gjatë debateve mbi Marrëveshjen e Prespës, zërat klerikë rusë i bënë jehonë argumenteve nacionaliste kundër kompromisit, duke paralajmëruar për "herezi të imponuar nga Perëndimi" ose "humbjen e identitetit sllav". Rrjetet ortodokse ndërkufitare, veçanërisht me Bullgarinë, ndonjëherë përdoren për ta paraqitur mosmarrëveshjen mbi identitetin maqedonas si një "çështje shpirtërore".

Rusia i përdor këto rrjete për të përhapur dezinformim të butë - mesazhe kulturore dhe morale që delegjitimojnë liberalizmin perëndimor, vlerat e BE-së ose rolin e NATO-s në shoqëri.

Një ndikim i tillë fetar rrallë bën bujë në media, por përforcon skepticizmin afatgjatë ndaj Perëndimit.

4. Fuqia korporative dhe ekonomike

Ndikimi ekonomik është një nga mjetet kryesore në strategjinë e Rusisë për Ballkanin. Midis viteve 2006 dhe 2015, siç dokumentohet nga hulumtimet mbi praninë e korporatave ruse në Maqedoni, firmat ruse blenë aksione në sektorët e energjisë dhe minierave. Varësia nga energjia është fuqia më e qëndrueshme: Maqedonia e Veriut importon pjesën më të madhe të gazit dhe naftës së saj përmes rrjeteve rajonale të lidhura me Rusinë.

Mesazhet ekonomike shpesh përzihen me dezinformata, duke e portretizuar pajtueshmërinë me sanksionet e BE-së si të dëmshme për ekonominë maqedonase, edhe pse këto sanksione zvogëlojnë varësinë nga Rusia dhe mbrojnë sistemin ekonomik në planin afatgjatë.

5. Inteligjenca dhe operacionet e fshehta

Së fundmi, NHMI-ja ruse është forcuar nga aktiviteti i inteligjencës. Autoritetet në Maqedoninë e Veriut dhe Bullgari kanë akuzuar vazhdimisht publikisht shërbimet sekrete ruse për ndërhyrje aktive:

- Në vitin 2018, pak para referendumit për emrin, qeveria dëboi diplomatët rusë të akuzuar për aktivitet subverziv.
- Në vitin 2022, kryeministri bullgar Kiril Petkov dhe presidenti maqedonas Stevo Pendarovski ranë dakord se shërbimet sekrete ruse po punonin për të ndezur tensionet dypalëshe midis dy vendeve dhe për të bllokuar progresin e BE-së.
- Dosjet e zbuluara të inteligjencës (Guardian, 2017) zbuluan një strategji afatgjatë të Kremlinit

për të mbajtur një rrjet informatorësh, OJQ-sh dhe agjentësh me ndikim në politikën dhe median maqedonase.

Të marra së bashku, këto pesë kanale demonstrojnë se si Rusia ushtron një ndikim hibrid shumëplanësh në Maqedoninë e Veriut, dhe situata është e ngjashme në Bullgari. Duke synuar njëkohësisht hapësirën e informacionit, politikën, kulturën, ekonominë dhe sigurinë, Moska siguron që edhe nëse një kanal është i ekspozuar ose i dobësuar, të tjerët vazhdojnë të formësojnë opinionin publik.

Qëllimi përfundimtar nuk është kontrolli i drejtpërdrejtë, por minimi i vazhdueshëm: gërryerja e besimit në integrimin euroatlantik, nxitja e mosmarrëveshjeve me fqinjët dhe mbajtja e vendit mjaftueshëm të paqëndrueshëm sa të shërbejë si shembull i dështimit në zgjerimin e BE-së.

Mosmarrëveshjet dypalëshe – një cenueshmëri që ofron hapësirë për NHMI-në ruse

Raporti i tretë i EEAS (Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm) mbi kërcënimet nga NHMI-të thotë se "fushatat ruse kërkojnë të shfrytëzojnë dobësitë specifike lokale në sferat politike, sociale dhe teknologjike me përmbajtje të përshtatur me kujdes, veçanërisht aty ku Rusia kërkon të përparojë interesat e saj të politikës së jashtme dhe të sigurisë".

Në fakt, mosmarrëveshjet dypalëshe midis Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veriut krijojnë një situatë vulnerabël që Rusia e shfrytëzon për NHMI-në. Vetoja e Bullgarisë në procesin e integrimit evropian dhe këmbëngulja e saj për lëshime historike/gjuhësore krijojnë narrativa që natyrshëm gjejnë jehonë të fortë në debatin publik në Maqedoninë e Veriut. Mediat dhe aktorët e lidhur me Rusinë i amplifikojnë këto narrativa përtej kufijve. Ndonjëherë aktorët vendas bullgarë (politikanë, media, intelektualë) prodhojnë materiale që bëhen lëndë e parë për fushatat e Moskës, dhe në raste të tjera, rrjetet ruse përhapin narrativa që nxisin nacionalizmin me qëllim që të fitojnë apel rajonal. Ndërveprimi është dypalësh.

Megjithatë, Sofja nuk është një përfaqësuese e Kremlinit, por një aktor politik i veçantë me motivet e veta, veprimet e të cilit ende mund të përdoren në operacione ndikimi të jashtëm. Konkretisht, nxitësit më të mëdhenj të ngërçit të reformave dhe përparimit të ngecur të Maqedonisë drejt BE-së janë të brendshëm, siç janë kufizimet kushtetuese në Maqedoninë e Veriut mbi pakicën bullgare ose vendimi i vetë BE-së për të lejuar që mosmarrëveshjet dypalëshe të formësojnë rendin e pranimit. Këto fakte strukturore dhe politike do të ekzistonin edhe pa ndikimin rus. Roli i Rusisë është të marrë këto shkaqe rrënjësore dhe të përforcojë fuqinë e tyre politike. Përmes narrativave mediatike, ndërmjetësve, sinjalizimit të politikave energjetike dhe aktiviteteve të fshehta, Moska rrit rëndësinë e çështjeve të diskutueshme, rrit mosbesimin publik dhe rrit koston politike të kompromisit në Shkup (dhe ndonjëherë në Sofje). Kjo i bën shumë më të vështira për t'u zgjidhur problemet e negociatave të zgjidhshme.

Ky studim tregon se Rusia vepron në mënyrë më efektive në momentet e vendimmarrjes (referendume, zgjedhje, tronditje energjetike). Duke shpikur ose amplifikuar dezinformimin në këto momente, ajo mund të ndryshojë llogaritjet politike (duke shtypur pjesëmarrjen, duke nxitur protesta). Referendumi i Prespës (2018) dhe vetoja bullgare (nga viti 2020 e tutje) janë ilustruese: rrjetet ruse janë përpjekur të formësojnë perceptimet dhe të mobilizojnë masat në momente kritike.

Dëshmi të drejtpërdrejta të NHMI-së ruse mund të citohen si përsëritja e dokumentuar e koordinuar e narrativave dhe amplifikimi ndërkufitar, përdorimi i provuar i rrjeteve sociale, fermave të troll-eve dhe teknikave të "pastrimit" të përmbajtjes në hapësirën informative maqedonase, si dhe emërtimi publik

dhe dëbimi i operativëve dhe diplomatëve nga vendet e prekura (Maqedonia e Veriut dhe Bullgaria), gjë që tregon operacione aktive të inteligjencës.

Duhet theksuar se Rusia nuk është arsyeja themelore për ngecjen e integrimit evropian të Maqedonisë së Veriut. Trajtimi i Moskës si e keqja e vetme rrezikon të humbasë kompromiset e brendshme të nevojshme për të ngushtuar hapësirën për ndikim të huaj. Nga ana tjetër, mosmarrëveshjet politike me Bullgarinë krijojë "municion" që Rusia mund ta përdorë për të zgjatur dhe vonuar proceset e integrimit evropian.

Bibliografia

Analytics.intsecurity (n.d.) *Bulgaria and Macedonia, Montenegro*. E disponueshme në: https://analytics.intsecurity.org/en/bulgaria-and-macedonia-montenegro [Qasur më 21 tetor 2025].

Bellingcat (n.d.) *Russian interference in Macedonia*. E disponueshme në: https://www.bellingcat.com/news/uk-and-europe/2020/07/04/russian-interference-in-north-macedonia-a-view-before-the-elections/ [Qasur më 2 tetor 2025].

Dugin, A. (n.d.) *Dugin in Macedonia*. E disponueshme në: Dugin vo Makedonija [Qasur më 24 tetor 2025].

Democratization Policy Council (n.d.) *Tail wagging the dog*. E disponueshme në: http://www.democratizationpolicy.org/tail-wagging-the-dog/ [Qasur më 22 tetor 2025].

EDMO (n.d.) *Literature review on disinformation actors*. [online] E disponueshme në: https://edmo.eu/wp-content/uploads/2025/06/EDMO-Report-Literature-review-on-actors-of-disinformation-in-the-European-Union-.pdf [Qasur më 14 tetor 2025].

EEAS (n.d.) *Information integrity and countering FIMI*. European External Action Service. E disponueshme në: https://www.eeas.europa.eu/sites/default/files/documents/2025/EEAS-3nd-ThreatReport-March-2025-05-Digital-HD.pdf [Qasur më 14 tetor 2025].

EP Think Tank (n.d.) *Russia and the Western Balkans*. European Parliament Think Tank. E disponueshme në: https://epthinktank.eu/2023/04/18/russia-and-the-western-balkans-geopolitical-confrontation-economic-influence-and-political-interference [Qasur më 11 tetor 2025].

Geopost (n.d.) *Russia's influence in RNM and Bulgaria*. E disponueshme në: https://thegeopost.com/en/news/russias-influence-in-north-macedonia-rnm-and-bulgaria-an-obstacle-to-unlock-the-eurointegration-process/ [Qasur më 12 tetor 2025].

Global Influence Ops (n.d.) *Russian influence amid stalled accession*. E disponueshme në: https://www.global-influence-ops.com/north-macedonia-warns-eu-of-growing-russian-influence-amid-stalled-accession [Qasur më 21 tetor 2025].

Guardian (2017) *Russia stoking discord in Macedonia. The Guardian*. E disponueshme në: https://www.theguardian.com/world/2017/jun/04/russia-actively-stoking-discord-in-macedonia-since-2008-intel-files-say-leak-kremlin-balkan-nato-west-influence [Qasur më 20 tetor 2025].

IEMed (n.d.) *Bulgaria as an obstacle*. European Institute of the Mediterranean. E disponueshme në: https://www.iemed.org/publication/north-macedonia-after-greece-bulgaria-appears-north-macedonias-obstacle-course-to-enter-the-eu/ [Qasur më 15 shtator 2025].

Intellinews (n.d.) *Macedonian president accuses Russian secret services*. E disponueshme në: https://www.intellinews.com/north-macedonia-s-president-says-russian-secret-services-are-behind-rift-with-bulgaria-267826/ [Qasur më 24 shtator 2025].

ISS (n.d.) *Russia and the Western Balkans briefs*. Institute for Security Studies. E disponueshme në: https://www.iss.europa.eu/publications/briefs/russia-western-balkans [Qasur më 2 tetor 2025].

Lansing Institute (n.d.) *Russia's destabilization target*. E disponueshme në: https://lansinginstitute.org/2022/08/05/north-macedonia-as-a-russias-destabilization-target [Qasur më 13 tetor 2025].

Metamorphosis Foundation (2024) *Disinformation trends and narratives in the Western Balkans*. E disponueshme në: https://metamorphosis.org.mk/en/izdanija_arhiva/disinformation-trends-and-narratives-in-the-western-balkan-region-media-monitoring-report-july-september-2024/ [Qasur më 21 tetor 2025].

Politico (n.d.) *Time for Bulgaria and Macedonia to move forward. Politico*. E disponueshme në: https://www.politico.eu [Qasur më 26 shtator 2025].

PORTAL KOMBAT (2024) *A structured and coordinated pro-Russian propaganda network*. VIGINUM. Available at: https://www.sgdsn.gouv.fr/files/files/20240212_NP_SGDSN_VIGINUM_PORTAL-KOMBAT-NETWORK_ENG_VF.pdf [Qasur më 21 tetor 2025].

ResearchGate (n.d.) *Russia's corporate influence*. E disponueshme në: https://www.researchgate.net/figure/Russias-corporate-influence-in-North-Macedonia-2006-2015_fig1_334335032 [Qasur më 22 tetor 2025].

RFE/RL (n.d.) *Bulgaria veto*. Radio Free Europe/Radio Liberty. E disponueshme në: https://www.rferl.org/a/macedonia-eu-bulgaria-veto/31910319.html [Qasur më 8 tetor 2025].

RFE/RL (n.d.) *Mattis warns of Russian influence*. Radio Free Europe/Radio Liberty. E disponueshme në: https://www.rferl.org/a/mattis-warns-against-russian-influence-campaigns-ahead-of-macedonia-name-referendum/29493980.html [Qasur më 4 tetor 2025].

RFE/RL (n.d.) *Petkov – Russian agents worked against good neighborly relations between Bulgaria and Macedonia*. Radio Free Europe/Radio Liberty. E disponueshme në: https://www.slobodnaevropa.mk/a/31782827.html [Qasur më 17 shtator 2025].

SAIS Review (n.d.) *How US history can save North Macedonia. SAIS Review of International Affairs*. E disponueshme në: https://saisreview.sais.jhu.edu/how-u-s-history-can-save-north-macedonia-and-defeat-putinism-in-the-balkans/ [Qasur më 12 tetor 2025].

Telma (n.d.) *Russian diplomatic-ecclesiastical games with Macedonian strategic interests*. E disponueshme në: https://telma.com.mk/2023/09/26/ruski-diplomatsko-crkovni-igri-so-makedonskite-strateshki-interesi/ [Qasur më 9 tetor 2025].

Vulnerability Index (n.d.) *North Macedonia*. E disponueshme në: https://www.vulnerabilityindex.org/north-macedonia.html [Qasur më 9 tetor 2025].

Institute of Communication Studies

respublica